

THE MAKER OF WORDS AND IMAGES: ISMAIL KADARE'S POETIC WORK 'SOME RAINDROPS FELL ON THE GLASS'

THE MAKER OF WORDS AND IMAGES: ISMAIL KADARE'S POETIC WORK 'SOME RAINDROPS FELL ON THE GLASS'"

Nikoleta KALLDRËMXHIU, Pavël SHKURTI

Co-worker of Institute of Language and Literature

Abstrakt

Poezia nuk është e paqartë, sa duket. Ajo mund të shfaqë imazhe po aq të sakta sa proza. Duke eksploruar poezinë e Kadaresë, kemi vënë re mbi 45 krahasime dhe 10 metafora që sjellin një përzierje unike të imazheve nga jeta e përditshme, natyra dhe mitologjia.

Përzierja e stileve sjell fjalë nga fusha semantike e fenomeneve natyrore: kristal bore, re, qiell, breshër, hënë, dimër, vjeshtë, ku termi shkon dorë për dorë me kuptimin e tij dhurues; krijimtaria bashkë me shkatërrimin si pjesë e natyrës dhe fuqisë njerëzore. Ose fjalë të tjera me natyrë shkencore si: polen, projekt, mesjetë, plotësojnë panoramën e mënyrës se si tema e dashurisë paraqitet në perceptimin e autorit. Për të plotësuar imazhet shërbejnë edhe fjalë të stilit bisedor të përdorura si krahasime. Të gjitha fjalët-simbol të tij janë dhënë në çdo pozicion semantik për të treguar kuptimin e tyre shpirtëror dhe të përtëritur, së bashku me imazhet (në forma, grafikë dhe fotografi). Çdo fjalë jepet me një përkufizim të shkurtër për një kuptim të vetëm; një shënim shpjegues me kontekst ilustrues ose citim ilustrues. Çdo fjalë mund të zëvendësohet me një sinonim me kuptim figurativ së bashku me imazhe. Disa imazhe do të vendosen në seri për të shpjeguar temat si pastërtia, bukuria, romanca, transformimi etj.

Meqë nuk mund të shkruajmë shkurt për Ismail Kadarenë, menduam një punim të larmishëm që paraqet pjesë të një projekti për kabinetin e gjuhës shqipe dhe temave e shkrimtarëve të shquar shqiptarë, të cilat mund të eksplorojnë dhe të sjellin kënaqësi. Mendojmë të shërbejë si qasje e shumëfishtë që ndërthur njohuritë shkencore me realitetin e shoqërinë.

Fjalë kyçe: fenomene natyrore, fjalë-simbol, projekt ndërdisiplinor, temë letrare, fushë semantike

Abstract

The poetry is not vague. It might appear images as exact as the prose. Exploring the poetry of Kadare we have noticed more than 45 simile's and 10 metaphors which bring the unique blend of common life images ,nature and mythology.

Mix of styles brings words from the semantic field of natural phenomena: crystal of snow, clouds, skies, hail, moon, winter, autumn, where term goes hand by hand with its donation meaning; creativity with the devastation as a part of nature and man power. Or other scientific words like: pollen, project, medieval complete the picture of how love theme looks like in author perception. To fulfill the images serves even colloquial words used as similes. All his symbol words are given in any semantic position to show their spiritual and revitalized meaning, along with their images (in shapes, graphics and photographs). Each word is given in a single short definition for one sense of it; an explanatory note illustrative context or illustrative quotation. Each word could be substituted by some synonym figurative meaning along with images. Some images will be set in a series to explain the theme of purity, beauty, romance, transformation etc.

As we cannot write shortly for Ismail Kadare this coloured paper is the part of the project for a cabinet of Albanian language and themes of Albanian eminent writers, which one can explore and even takes pleasure. We think it might serve as interconnections by a first glance for other school subjects.

Key words: natural phenomena, symbol-word, cross subject project, literature theme, semantic field

Hyrje

Ky punim synon të shqyrtojë përdorimin e elementeve natyrore në gjuhën poetike të Ismail Kadaresë, duke i organizuar ato në fusha leksikore, semantike dhe konceptuale. Përmes analizës së këtyre motiveve dhe funksioneve të tyre, synohet të zbulohet lidhja e thellë ndërmjet simbolit poetik, rezonancës emocionale dhe mendimit filozofik. Në të njëjtën kohë, studimi vë në dukje rolin e veçantë të figuracionit në poezinë kadareane—si një mjet artistik që ngjall përjetime të fuqishme dhe të ndjeshme, duke i dhënë vargut jetë dhe duke ndërtuar një urë ndjesore e mendore mes lexuesit dhe tekstit.

Poezia e Ismail Kadaresë gjatë viteve 1980 përfaqëson një ndërthurje të veçantë mes thellësisë intelektuale dhe ndjeshmërisë emocionale. E ndërtuar përmes një forme të rafinuar artistike, ajo krijon një hapësirë reflektimi të qetë, ku arsyeja dhe ndjenja bashkëveprojnë në mënyrë harmonike. Kjo poezi, e frymëzuar nga filozofia, shkenca dhe arti, ngre pyetje që i tejkalojnë përmasat individuale dhe i drejtohen të përbotshmes e shoqërores.

Një prej veçorive më të dallueshme të kësaj poezie është ndërtimi simbolik kompleks. Fenomenet natyrore — si shiu, bora, kristali apo xhami — nuk shërbejnë vetëm për përshkrime, por bëhen mjete të fuqishme metaforike që lidhin botën konkrete me atë abstrakte. Nëpërmjet këtyre figurave, natyra shndërrohet në një mjedis reflektues, ku mendimi dhe ndjenja bashkohen për të ofruar kuptime të shumëfishta. Këto elemente janë veçanërisht të pranishme në vëllimin “Disa pika ranë mbi qelq”, ku natyra nuk përshkruhet thjesht, por bëhet pasqyrues i thellësisë poetike dhe meditative mbi qenien dhe botën.

Ndërthurja mes fjalës dhe figurës poetike në poezinë e Kadaresë zbulon gjithashtu fuqinë shumëdimensionale të gjuhës. Fjalët që lidhen me natyrën bartin shpesh ngarkesë simbolike dhe përfaqësojnë ide që lidhen me disiplina të ndryshme si shkenca natyrore apo filozofia. Shiu, për shembull, nuk përfaqëson vetëm një fenomen atmosferik, por edhe një cikël pastrimi e rilindjeje; kristali dhe xhami nënkuptojnë brishtësinë, kthjelltësinë dhe reflektimin. Këto terma të zgjedhur me kujdes hapin shtigje për interpretim simbolik dhe krijojnë një lidhje të fortë atmosferike midis lexuesit dhe vargut poetik.

Fjala dhe imazhi te poezia “Mall” (Efektet stilistikore në raporte paradigmatiche dhe sintagmatike)

Fusha leksikore-semantike	fjala	Përkufizimi	
Matematikë-geometri	Pikë Pika shiu Ca pikë shiu ranë mbi qelq Ylber	Një vendodhje specifike që nuk ka përmasa . Identifikohet me koordinata . Nuk janë përfekte sferike, marrin formën e një hambari ndërsa bien. Nëse do të vendoseshin në një sistem koordinativ dy dimensional: X është vendodhja horizontale e pikës dhe Y është lartësia (ose pozicioni vertikal) i pikës në raport me rrafshin, në këtë rast qelqi Ashtu siç përshkruhet FGJSSH 2002 pika është një e dhënë , një shenjë përveç të tjerash (Disertacionin doktoral, Nikoleta Kalldrëmxi, Tiranë 2019) hark	
Fiziko-kimike	1. shiu	1. formë e lëngshme, në temperaturë të ngjashme me ambientin, zakonisht i	

B	2.Qelq 3.Ylber 4.Qiej	tejdukshëm , por ndryshon ngjyra për shkak të ndotjes, ph 5.5 1.2 pastron ambientin, nxit rritjen e bimëve 2. Qelqi ka transparencë, është i brishtë ndaj ndryshimeve dhe ka strukturë kristalore pa rregullim periodik. 3.ka shtatë ngjyrat e spektrit të dritës Hapësira që ndodhet mbi tokë dhe që është e mbushur me ajër.
Biologji C	5.Shi lejlekë	5.Forcë themelore në funksionimin e ekosistemeve duke mbështetur jetën në shumë mënyra Zogj migratorë, mungesa e të cilëve sugjeron dimër
Gjeografi D	qytet	vend
letërsi	Shira pa ylber në mes Qiej të ngrysur pa lejlekë 3.Ca pika shiu ranë mbi qelq	Metaforë që shpreh pamundësinë e shpresës , pajtimin apo një realiteti të ashpër pa ndriçime të mëdha. Një hapësirë që përfaqëson botët dhe kulturat e ndara Një atmosferë të pasigurisë dhe pasivitetit, e cila lidhet me ndjenjat e përshkruara 2. Lejlekët janë simbol i lirisë së udhëtimit dhe ndërrimit të hapësirës dhe kohës. Fluturimi i tij simbolizon largimin nga një vend dhe kalimin në një tjetër, si shenjë e hapësirës dhe mundësive për zhvillim 3.paqartësi Kuptimi simbolik i shiut – i përzjerë me mungesën e elementeve të tjera natyrore si ylberi, apo shiu në qelqe , përfaqëson mungesën e qartësisë dhe pasigurinë. I përzjerë me fjalën pikë ato bëhen shenja paralajmëruese të përjetimeve dhe thirrjes emocionale të autorit .
Gjuhë shqipe	Shira pa ylberë në mes, qiej të ngrysur pa lejlekë Fusha leksikore e foljeve: ranë, ndjeva, jetojmë, shihemi, m'u	Përfitim morfologjik për të përforcuar dukurinë Përsëritja e foljes <i>rënë</i> në dy sintagma <i>shiu ra mbi qelq</i> (pamje e turbullt) dhe <i>kemi rënë në ëndërr</i> (një atmosferë e izolimit emocional), një botë që është bërë e paqartë, ku njeriu mbyllet në vete si mbrojtje nga boshllëku jashtë.

	duk, erdhi, kemi rënë , zgjohemi.		
--	-----------------------------------	--	--

Fjalët e mësipërme bëjnë pjesë në fushën leksikore të elementeve natyrore dhe dukurive atmosferike që krijojnë një lidhje të ngushtë me botën rreth nesh. Shprehja "*Ca pika shiu ranë mbi qelq*" ka kuptim figurativ: qelqi paraqet pasivitetin dhe pasigurinë, ndërsa pikat e shiut simbolizojnë ndjenja të brishta. Kjo krijon një kontrast mes realitetit të ashpër dhe shpresës — një "ylber" që nënkupton mundësinë e ndryshimit dhe zhvillimit përmes kalimit nga një gjendje në tjetrën, duke përdorur imazhe të natyrës për të shprehur ndjenja dashurie dhe aspirate.

Ne ç'ëndërr kemi rënë kaq keq gjithashtu ka një nuancë të humbjes, pasigurisë dhe paqartësisë njëloj si shiu mbi qelq. Pranëvënia e tyre plotëson imazhin e poezisë.

Sipas Ali Podrimjes fatin e individit nuk mund ta shohim ndaras fatit të popullit, siç nuk mund ta pranojmë triumfin e kombëtares si fitore fisi, por të kombit. Tek e lexon një poezi me subjekt dashurie, bindesh se ke hapur një fletë tronditëse nga historia njerëzore, ashtu depërton në çështje më qenësore të ekzistencës së një populli. Po të ndalemi të thënia e Heraklitit: "të zgjuarit janë bashkë, kurse të fjeturit janë veç". Thënie kjo e njohur e që Kadare i gjen vendin në strofën e tretë të poezisë së lartpërmendur. Nuk i gjen këto asosacioneve me mbylljen tonë



një gjysmëshekulli, se vërtet tepër gjatë ishim në gjumë, as veten nuk e njihnim se na mungonte kuraja (A. Podrimja, *Parathënie, Ca pika shiu ranë mbi qelq, Ulpianë 2003*)

Njeriu që vështrohet pas xhamave në shi duke u ndjerë i brengosur nga malli, pasqyron një ndjenjë izolimi (sa rrallë shihemi, sa rrallë). Pikat e shiut mbi xham krijojnë një pengesë fizike



dhe emocionale, një mur mes tij dhe botës së jashtme, ndërsa mendon një moment qartësie ose shprese për të dalë nga vetmia.

Paralelja me një popull të burgosur, ku njerëzit ndihen të ndarë nga bota e tyre e natyrshme, të shtypur e pa shpresën e çlirimit. Imazhi përfaqëson jo vetëm melankolinë por është thirrje për një zgjim të brendshëm e të jashtëm.

Fjalët dhe imazhet te “Rënia e dëborës”

Fusha leksikore-semantike	fjala	Përkufizimi dhe imazhi
Matematikë-Gjeometri	Kristale dëbore 	Kristalet e dëborës janë një çudi përrallore, bukuri dhe ndërlikueshmëria e së cilës janë zbuluar nga mikroskopi. Janë unike (Wilson Bentley). Kanë formë gjilpëre në 2^0 C dhe në -2^0 C kanë formë gjashtëkëndore.
Fiziko-kimike	Dëborë, kristale dëbore Ernat Qielli (I ftohtë hapej madhërisht)	Rrjedhje e ajrit që prodhon stuhi në dëborë dhe rrëshqitje Mungesa e ngrohtësisë diellore; mungesa e pengesave atmosferike
Biologjic	flokët	<i>Qimet e kokës së njeriut; funksionet e së cilave janë të lidhura ngushtë me mbrojtjen, ndjeshmërinë, termorregullimin dhe adaptimet ndaj mjedisit</i>
gjeografi	Nata.mëngjesi	Koha nga perëndimi në lindje dhe mëngjesi nga lindja në perëndim
Letërsi	Qielli bashkëpunoi, projektoi çdo kristal , punoi, qielli i zbehtë, i ftohtë, hapej madhërisht Altruizmi i hirtë i qiellit	Qielli dhe erërat janë simbole të pafundësisë dhe fuqisë së madhe. Ato vendosin një lidhje me tokës (ku janë

	Flokët Debora	njerëzit) dhe qiellit (si një forcë hyjnore Delikatesa femërore, aftësia për të ndryshuar Dëbora dhe kristalet e saj shpesh simbolizojnë pastërtinë, pafajësinë dhe ndjesinë e rigjenerimit. Këto simbole janë të ngarkuar me një kuptim të thellë shpirtëror.
Gjuhë shqipe	Qielli Ernat Fjala “kristal” rrjedh nga greqishtja e lashtë (krystallos) që do të thotë akull dhe Kristal shkëmbi; nga (kruos) i ftohtë, i akullt, ngrica)	E rivalizuar. Përkon me kuptimin e vjetër të fjalës që do të thotë Krijuesi, Perëndia Përdorimi në shumës i jep forcë më të madhe poezisë Kristale bore është përdorim specifik terminologjik përkundëjt përdorimit të përgjithshëm flokë bore Fusha leksikore e foljeve; nuk të shkoi ndër mend, s’u mbyll, shtroi, ra, u projektua, s’pushoi, gjeti, shkundi, punoi, hapej, shëtisim

Prerja e bashkësive semantike për fjalën dëborë, kristale dëbore, erëra, qiell dhe flokë lidhet me disa fusha kuptimore që ndërthuren duke krijuar një rrjet simbolik dhe filozofik. Këto fjalë ndajnë një kontekst të përbashkët që mund të klasifikohet sipas disa aspekteve:

1. **fusha semantike e natyrës** që përfaqësojnë ndryshueshmërinë e motit , ciklet natyrore dhe ndjesinë e lidhjes së njeriut me universin.

2 . **fusha e ndjeshmërisë dhe përjetimeve estetike:** flokët dhe kristalet e dëborës përshkruhen për të evokuar bukuri dhe delikatesë. Ato janë të mbushura me simbolikë vizuale. **Dëbora** dhe **flokët** krijojnë një ndjesi përkohshmërie dhe harmoni mes natyrës dhe qenies njerëzore.

3. **simbolika e pastrimit dhe dëlirësisë** Dëbora dhe kristalet e saj shpesh simbolizojnë pastërtinë, pafajësinë dhe ndjesinë e rigjenerimit. Këto simbole janë të ngarkuar me një kuptim të thellë shpirtëror.

4. **Fusha e lidhjes së qiellit me hapësirën e përjetshme.** Qielli dhe erërat janë simbole të pafundësisë dhe fuqisë së madhe. Ato vendosin një lidhje me tokën (ku janë njerëzit) dhe qiellit(si një forcë hyjnore ose universal. Qielli është burim i dëborës duke e lidhur atë me dhuratën dhe bujarinë hyjnore

Fusha e përkohshme dhe e kalueshmërisë Dëbora, kristalet e dëborës simbolizojnë momente të kalueshme bukurie, që janë të përkohshme, ashtu si dëbora si shkrihet apo flokët që përthithin kohën dhe hapësirën.

Prerja e fushave semantike (AnBnCnD) përfaqësojnë dhe fushat konceptore të fjalëve: dëborë, dhe ndërthur elementet natyrore (kristale dëbore, qiell, erna), elementet njerëzore (flokët), simbolikën e përkohshme dhe të bukurisë së thyeshme dhe e kalueshmërisë së momenteve të bukura. Mund të shtojmë dhe **fushën konceptore të misterit, trashendenca,**

kujtesa dhe ndjeshmëria personale , si dhe **unikja** .Lexuesin nxitet të meditojë si për përditshmërinë ashtu edhe për universin.

Kristalet e dëborës simbolizojnë Khionen, perëndeshën e dëborës. Përmes mitit, shkrimtari krijon një lidhje mes natyrës dhe mendjes njerëzore. Dëbora shfaqet si një forcë që ndryshon gjithçka: mbulon të kaluarën dhe i jep momentit një ndjesi të re, të pastër dhe të bukur. Ajo është si një dhuratë nga qielli, e butë dhe qetësuese, por njëkohësisht edhe e rrezikshme, pasi mund të shkaktojë rrëshqitje, izolim dhe të ftohtë të madh. Pra, dëbora përfaqëson dy anët e natyrës — bukurinë dhe rrezikun.

Qielli nga një anë është simbol i fuqisë së pandalshme të natyrës . Altruizmi i qiellit bëhet i trishtë sepse, pavarësisht përpjekjes për ta kënaqur vajzën, ai nuk mund t'i kontrollojë efektet anësore të dhuratës së tij. Kjo e bën aktin e tij një sakrificë të pamenduar, **ku bukuria dhe rreziku janë të pandashme**. Ajo është një shenjë paralajmëruese, se qielli si metaforë e natyrës e cila i jep njeriut dhurata ta mëdha, por edhe pasoja që duhen kuptuar dhe respektuar. Kjo e bën lexuesin të reflektojë mbi dualitetin e bukurisë natyrore dhe njerëzore, fuqinë dhe rrezikun e saj. Miti është tabuja e pakapërcyeshme midis idilit dhe superegos.

Flokët si detaj për të përshkruar bukurinë, intimitetin dhe lidhjen me natyrën si dhe ndjesitë e brendshme natyrisht edhe këtu mbeten simbole të feminitetit, të femrës së idealizuar. Flokët



që valëviten në erë mbulohen nga bora, simbolizojnë kalimin e kohës dhe ndjesinë e përjetimit të një moment të përkryer, por edhe kalimtar të gëzimit. Lexuesi fillon e mediton mbi momentet e vogla të gëzimit.

Kristale bore është përdorim specifik terminologjik përkundrejt përdorimit të përgjithshëm flokë bore që është sinonime i tij në këtë rast. Kristali një katedrale në miniaturë me bukuri kozmike merr kuptimin simbolik të fjalës *kristal*: **dhuratë bukurie e përkohshme, sepse** dhe vete bukuria është e tillë.

Përmbledhje: Lexuesin nxitet të meditojë si për përditshmërinë ashtu edhe për universin. Nga ana gjuhësore fusha leksikore e foljeve përfaqëson fjalë të zgjedhura që lidhin përditshmërinë e momentet e çlodhjes me punën, si: *nuk të shkoj ndër mend, ra për ty, shëtisnim e nga ana tjetër u projektua, s'pushoi dhe gjeti*. Emrat nga ana tjetër përdoren gjithashtu dyfish të specializuar, si për të dhënë ngjyime emocionale, ashtu edhe për të dhënë leksikun dituror, duke e afishuar me të vërtetë si intelektualiste. Përshkrimi i momenteve të vogla të jetës jepet në një dimension estetik e simbolik.

Nga pikëpamja letrare fantastikja, me të cilën e ndërthur të përditshmen që i lë vend fantazisë dhe i jep një shije tjetër të jetës. Sipas Kadaresë çdo dukuri imagjinare është e mundur të ndodhë e të realizohet. (N. Kalldrëmxhi, Sh. Rrokaj Rritja e kompetencës leksiko-semantike te fëmijët, disertacion, Tiranë 2019, fq 76) nga ky lloj i fantastikes merr jo vetëm përmasën e mrekullueshme, por edhe të tronditjes dhe rrezikut. Të dhënat shkencore që i merr nga fusha tematike e meteorologjisë e me të cilën ndërton figuracionin artistik, mund ta çojë lexuesin edhe në disa asosacione mendimi që lidhen me përgjithësime filozofike të vetë jetës, si: *Dëbora është e bukur, por e ftohtë*. Kjo na bën të themi se të tre provat me të cilat ne operuam; analiza



gjuhësore, ajo stilistike gjuhësore dhe imazhi na çojnë në të njëjtin përfundim. Nuk njohim ndonjë kontekst historiko-shoqëror të shprehur nga ndonjë autor për poezinë, ndaj edhe për shkak të simboleve po e vendosim te tema universal ekzistencialiste dhe dashurisë, ku vetë dashuria është një forcë që zbërthehet në disa përbërës të cilët i cituam si nëntema. sikurse dhe kuptimet kontekstuale që fitojnë fjalët kristale dëbore=dhuratë, flokët=aftësia e njeriut për të ndryshuar, projektoj= arkitekturë e natyrës

Poezia *Kristal- fjala dhe imazhi*

Fusha leksiko-semantike	Fjala	Përkufizimi
Matematike-gjeometri	Kristal	Ekzistojnë rreth 47 forma të kristaleve. Forma e tyre lidhet me simetrinë.(kubik, tetragonal, ortorombik etj.)
Fiziko-kimike	Kristal Mermer	Fortësia , transparenca , e thyejnë dritën, aftësia për të shfaqur dy ngjyra të ndryshme , dritë të polarizuar Qëndrueshmëria në prani të reagentëve kimikë etj Material i ftohtë solid
biologji	Flokët polen	Funksionet e tyre janë të lidhura ngushtë me mbrojtjen , ndjeshmërinë , termorregullimin dhe pershtatjen ndaj mjedisit Element me funksion riprodhues në botanikë
gjeografi	Hon, fushë	Një humnerë thellësie ose hapësirë pafund e errët, në pozicion vertikal ; hapësirë e sheshtë dhe e hapur që lidhet me peizazhin rural në pozicion horizontal
letërsi	Flokët	Feminilitetin dhe sensualitetin, fuqi dhe vitalitet dhe rininë Lidhja dhe kujtesa. Shpesh në letërsi ruajtja e fijeve të flokut përfaqëson dikë që ka vdekur.

	Morg-Kristali Mermer Si polen Strofë, notë hon fushë	Flokët përfaqësojnë një lidhje emocionale midis heroit lirik dhe vajzës. Flokët janë shenja e parë e ndryshimit moshor dhe shpirtëror Kristali simbolizon pastërtinë, transparencën dhe përjetësinë , dritën , pastërtinë , shpirtin Dedikim , promemorie Mermeri është i lidhur me artin dhe monumentet shpesh i përdorur për të krijuar statuja që synojnë përjetësinë. Kjo nënkupton një simbol të vendit, ku ajo çka bërë meriton mirënjohje ose lavdi. Simbolizon fjalën poetike ose idetë; të cilat shpërndahen butësisht në mendjet e njerëzve, por kanë një efekt të fuqishëm dhe masiv. Mund të përfaqësojë procesin e paprerë të përtëritjes së ideve, traditave dhe ndjenjave që është një mënyrë delikate, por gjithmonë e pranishme. Fjalën poetike, muzën Humbje dhe trishtim; të fshehtat e historisë Hapësira e përballjes; humbja e individit në vorbullën e historisë (Shqipëria dhe bota në veprën e Kadaresë, Ndriçim Kulla, Parathënie e albumit, Tiranë 2016, fq.14)
Gjuhë shqipe	- Morg-kristal Lulnajë	<i>Shpreh dualitetin e bukurisë së pastër me ftohtësinë e vdekjes. Kjo bukuri është e ngrirë në kohë dhe në hapësirë, ndoshta e paarritshme. Kontrasti midis të bukurës dhe tragjikes</i> <i>Neologjizëm-një vend ku mbretëron harmonia, bukuria dhe ngrohtësia</i> <i>Mund të jetë një çast lulëzimi i përkohshëm dhe delikat</i>

Shprehja “morg-kristal” mund të simbolizojë një qytetërim ose kulturë të ftohtë dhe të mbyllur, që është estetikisht e përsosur, por e largët dhe e paarritshme. Ajo përfaqëson një bukuri të ngrirë dhe të përjetshme, e cila mbart ndjenjën e ftohtësisë dhe vetmisë. Ky kontrast mes bukurisë dhe ftohtësisë pasqyron tensionet që Kadare përdor për të thelluar përmasën filozofike të poezisë së tij.

Nga ana tjetër, fjalë si “polen”, “strofë” dhe “notë” përfaqësojnë delikatesën dhe fuqinë e fshehtë të natyrës, artit, dashurisë dhe kulturës. Këto elemente të vogla tregojnë se edhe gjërat më të thjeshta mund të kenë ndikim të madh në jetën njerëzore, duke udhëhequr krijimin dhe ekzistencën.

Po ashtu, shprehje si “honi i historisë” dhe “fusha e betejës” simbolizojnë përballjen e njeriut me tragjedi, sfida dhe të panjohurën. Ato janë si projeksione të një “pike” – simbol i muzës së poetit – në dy drejtime: në horizontale, që përfaqëson përballjen intelektuale dhe njerëzore të poetit, dhe në ballore, ku mund të imagjinojmë një pllakë mermeri apo kristali, si pjesë e veprës artistike.

Në kontekstin e analizës letrare për maturanët, poezia “Ca pika shiu ranë mbi qelq” është një shembull i veçantë i trajtimit metaforik të dashurisë dhe kohës. Ajo paraqet një dashuri që nuk

i sjell poetit ripërtëritje. Titulli përcjell një qetësi të brishtë, ndërsa në nëntekst zbulohet drama dhe meditim i filozofik mbi kalimin e kohës dhe përjetësinë (R. Petro, Çelësi i letërsisë për maturanët, Tiranë 2010). Besojmë se ka ardhur koha që ky vëllim të rilexohet nga maturanët në një mënyrë më të thelluar dhe me këndvështrim të gjerë.

Plani simbolik i krahasimeve në vëllimin “Ca pika shiu ranë mbi qelq”

Përdorimi i krahasimeve në këtë vëllim poetik është i shpeshtë dhe mbart një ngarkesë të fuqishme simbolike. Krahasimet nisin nga elemente të përgjithshme të natyrës dhe përditshmërisë: “Drurët nxijnë tek-tuk si hajdutë”, “nata si një mbulesë gjigande”, “si një vetmi, si me maska” (Llora, fq. 23), duke shpalosur një atmosferë të zymtë e të mbyllur, që përçon ndjenja ankthi dhe përjashtimi. Në poezinë “Buzëqeshje mbi botë” (fq. 40), përdorimi i krahasimeve si: “si tërbim, si ndëshkim, si kryq, si një vetmi e madhe, si torta, si mbi mangall, si peshkop i trishtuar, si drita semaforësh”, pasqyron tensionin e brendshëm, përjetimet e forta dhe shpërbërjen emocionale të njeriut modern.

Krahasimet shpesh krijojnë pamje të gjalla dhe metafora ironike, si në vargjet: “Ai mori pirunin dhe mua m’u duk se / si torta / ndërtesat, stacionet, muzetë / bëhet gati t’i hajë” (fq. 40) ose “qytetet / si mbi mangall të largët” (fq. 41), duke nënkuptuar largësinë emocionale dhe ftohtësinë që i përshkon marrëdhëniet njerëzore dhe qytetërimin. Edhe natyra transformohet në funksion të gjendjes shpirtërore: “Si stof i keq u zbeh blerimi” (fq. 44), “retë si zarfa të mëdhenj notojnë”, “si dy qytete mesjetarë / me mure, heshta dhe pargje”, ku izolimi dhe mungesa e komunikimit kthehen në tema qendrore.

Krahasimet me fjalë teknike apo terminologji shkencore i japin poezisë një dimension modern dhe të reflektuar: “Lapsi më ngrinte mbi letër dhe unë ngrija si robot”, “vështrimi t’u err, t’u mpi / si sytë e falltarit”, “diçka që prishur në botë, në zemrek të saj, në aks” (fq. 32). Këto elemente pasqyrojnë një botë të çrregulluar, mekanike dhe të shpërbërë, ku edhe emocionet ndihen si pjesë e një sistemi të ftohtë.

Në mënyrë të veçantë, Kadare përdor krahasime me emra të përveçëm që mbartin simbolikë të thellë kulturore: “duken që larg si Don Kishoti”, “të lashta si të Gjon Buzukut”, “Prometeu si pasagjer nate”. Këto personazhe përfaqësojnë idealizmin, lashtësinë kulturore dhe vuajtjen e njeriut që kërkon të ndryshojë fatin e vet.

Poeti përdor edhe krahasime që nënkuptojnë fuqinë e gjërave të vogla: “ka dhe dashuri të mëdha të lira si era” (Pizhamet dhe aeroportet). Era, si simbol i lirisë dhe forcës, mbart edhe pasigurinë dhe ndryshimin. Po kështu, krahasimi “si demi që ripërtyp barin e livadheve të largët” (Llora, fq. 25) ngarkon figurën e dashurisë me simbolikën e qëndrueshmërisë dhe durimit, që i kundërvihet kalueshmërisë së kohës.. Akti i ripërtypjes i ngjan procesit të kujtesës që rikthen vazhdimisht ndjenja të thella — në këtë rast dashurinë — për ta përpunuar, për ta mbajtur gjallë, edhe pse ajo mund të jetë e largët në kohë apo hapësirë. Poeti sugjeron se dashuria nuk harrohet thjesht, ajo “përtypet” në heshtje dhe në mënyrë të brendshme, si një mendim i vazhdueshëm që kërkon kuptim dhe vazhdimësi. Kështu, krahasimi mbart edhe një lloj përlulësie përballë ndjenjës: të qëndrosh i palëkundur në përjetimin e saj, pa bujë, pa dramë — thjesht në një qëndrim të heshtur dhe të thellë.

Krahasimi “më rrëzëllente si smerald mërziya” është nga më delikatët në të gjithë vëllimin, sepse i jep një shkëlqim estetik një ndjenje të errët si mërziya. Smeraldi, si gur i çmuar, simbolizon jo vetëm bukurinë, por edhe vlerën e fshehtë që mund të mbartë një emocion negativ. Mërziya këtu nuk është thjesht një ndjesi pasive; ajo është e ndriçuar nga një dritë e brendshme, një bukurie që vjen nga thellësia e shpirtit dhe përjetimit të sinqertë. Kjo tregon se Kadare e sheh edhe trishtimin si pjesë thelbësore të jetës dhe të artit, si një emocion që, pavarësisht dhimbjes, mund të jetë poetik, përpunues dhe madje zbukurues për ekzistencën njerëzore.

Krahasime të tjera, si: “ne shtrihemi nën të, si në ethe zbulohemi”, shpërfaqin pasiguri, frikë dhe ndjenja të sëmura në një marrëdhënie, ndërsa “mbërthyer mbi krahët dhe këmbët e tua / si mbi një kryq të madh të bardhë” sugjeron një dashuri të madhe, të sakrifikuar dhe të pastër, që i ngjan një martirizimi të vetëdijshëm. Po ashtu, krahasimi “kur ti me shthurjen, unë me injorancën vërtiteshim si me maska” tregon shtirjen, mungesën e sinqeritetit dhe fshehjen e vetvetes në marrëdhënie.

Në vargun “si yje janë vërtet dashuritë / kërkojnë hapësira të mëdha e po aq mund” (fq. 32), yjet simbolizojnë dashurinë si një kërkim të pafund dhe të vështirë për përputhje shpirtërore. Në fund, edhe ndjenjat negative shfaqen përmes krahasimesh të hijshme: “më rrëzëllente si smerald mërzi”, “dhe lumturia ngrysej si një muzg me re”, duke treguar se për Kadarenë, edhe trishtimi ka një bukuri të vetën dhe është pjesë e thelbësore e përvojës njerëzore.

Fjalorth poetic

- **Ylber** – simbol i shpresës dhe pajtimit, por mungesa e tij në poezi tregon pamundësinë për ndriçim, mungesën e pajtimit ose të bukurisë pas dhimbjes.
- **Qie**ll – përfaqëson hapësirën e madhe emocionale, por në këtë poezi shpesh është i zbrazët, i mbyllur apo i mjegullt, çka tregon një realitet të ashpër dhe një botë pa dalje.
- **Demi** – simbol i forcës së brendshme, durimit emocional, përjetimit të heshtur dhe të thellë të dashurisë. Tek “si demi që ripërtyp...”, nënkupton përtypjen e kujtimeve dhe ndjenjave.
- **Smerald** – merr kuptimin e bukurisë së ndjenjave të dhimbshme, si mërzi, duke i dhënë asaj vlerë estetike dhe poetike. Shkëlqimi i smeraldit sugjeron një trishtim të përpunuar, të thellë e të bukur.
- **Erë** – simbol i lirisë, ndryshimit, paprekshmërisë. Në krahasimin “dashuritë si era”, nënkupton dashuritë që nuk mund të kufizohen, që janë të mëdha dhe të pakapshme.
- **Kryq** – metaforë e dashurisë sakrifikuese, shpesh edhe përkushtimit ose vuajtjes që vjen prej saj. Në vargun “si mbi një kryq të madh të bardhë”, sugjeron një ndjenjë të madhe që përjetohet me dhimbje e përlule.
- **Mërzi** – jo vetëm trishtim, por formë e thellë e ndjeshmërisë dhe reflektim për ndjenjat, që mund të jetë po aq domethënëse sa edhe lumturia.
- **Maska** – simbol i fshehjes së vetvetes, rolit të shtirur, ose mungesës së sinqeritetit në marrëdhënie. Tregon një distancim emocional dhe mungesë të intimitetit të vërtetë.
- **Yll** – metaforë për dashurinë e madhe, shpirtin binjak, diçka e lartë dhe e paarritshme që kërkon përkushtim dhe hapësirë për t’u realizuar.
- **Livadhi i largët** – simbol i kujtimeve të bukura, por të shkuara. Përdoret për të përshkruar distancën emocionale ose fizike ndaj diçkaje të çmuar që ka humbur.
- **Qelqi i thyeshëm** – metaforë për brishtësinë e shpirtit ose të marrëdhënies. Simbolizon diçka të çmuar që mund të copëtohet nga një prekje e gabuar.
- **Zarfet që notojnë në re** – figurë për mesazhet e paçarta, ndjenjat që lëvizin nëpër kohë, ose komunikimin mes njerëzve që nuk është gjithmonë i drejtpërdrejtë.
- **Polen** – simbol i diçkaje të vogël, por me fuqi të madhe. Tregon se gjërat e imëta si ndjenjat, kujtimet apo fjalët e buta mund të ndryshojnë shumë.
- **Strofë** – përfaqëson forcën e poezisë dhe artit. Tregon se edhe një pjesë e vogël poezie mund të shprehë ndjenja të mëdha.
- **Notë** – simbol i emocioneve të buta e të brishta, që shprehen përmes muzikës ose ndjeshmërisë. Edhe një notë e vetme mund të prekë thellë shpirtin.

- **Lejlek** – simbol i lirisë dhe kalimit. Shfaqet si shenjë e udhëtimit, e ndryshimit të kohës dhe hapësirës. Në poezi përfaqëson **largimin, ndryshimin dhe shpresën për një fillim të ri**.
- **Shi** – simbol i **trishtimit, pasigurisë dhe mjegullës shpirtërore**. Kur bie shi mbi qelq, krijon një ndjesi ndarjeje, vetmie, ose një realitet të ftohtë ku mungon shpresa dhe ngrohtësia
kristali i dëborës – simbol i **individualitetit, brishtësisë dhe bukurisë unike**. Çdo grimcë dëbore është e veçantë, si mendimet apo përjetimet njerëzore.
- **Projektoi** – folja tregon **veprim dhe ndikim**. Çdo kristal lë një **gjurmë imagjinare**, diku në hapësirën e madhe – si një mendim apo ndjenjë që shfaqet në mendje apo në shpirt.
- **Qielli i madh** – hapësira e pafund e **ndjenjave, kujtimeve, shpirtit apo vetëdijes kolektive**. Është si një ekran i madh ku secili kristal (përjetim) reflekton ose lë dritë.

Përfundim

Poezia e Kadaresë e ka zbukuruar gjuhën shqipe. Fjalët simbol të përdorura nga autori dhe që bëhen objekt i punës së gjuhëtarit dëshmojnë bukurinë dhe potencialin e gjuhës. Përmes formës së komunikimit në poezi dhe temave dashurore, imazhet përftojnë një sugjerim të thellë dhe estetik. Kjo lidhje ndërmjet artit dhe shkencës pasqyron shprehjen e emocioneve dhe kërkimin e së vërtetës. Imazhet e përdorura nga Kadareja, si fjala "kristal," krijojnë një simbolikë të pasur që i tejkalon kufijtë e fjalës dhe marrin përmasën e simbolit, duke shprehur ndërlikimet shpirtërore dhe intelektuale të njeriut.

Rëndësia e Fjalës në Poezi:

Fjala merr një rol të veçantë në poezinë e Kadaresë, duke i dhënë përjetimit intelektual një dimension të thellë. Në dukje të thjeshta, këto poezi bartin ide komplekse mbi dashurinë dhe lirinë. Përmes metaforave si "kristal" apo "smerald," poeti arrin të krijojë imazhe që pasqyrojnë një botë të tërë, të pasur me nuanca shpirtërore dhe kulturore. sinonime kontekstuale pasqyrojnë nuanca të thella të realitetit dhe sjellin në vëmendje rëndësinë e fjalës në kulturën shqiptare. Kadareja i jep një vlerë të re gjuhës shqipe, duke e sjellë atë si një ndërthurje mes modernes dhe tradicionaleve. Ndërmjet analizës në rrafshin kuptimor kanë dalë në pah edhe fjala dhe termi.

Fjalë-kristale, shi i lehtë dhe ylberë — këto janë luginat e gjuhës që çelin në kujtesën e një bote në lëvizje drejt së ardhmes. Ashtu siç vepron Natasha Sotiri në Fjalorin e Gjuhës së Ismail Kadaresë, për të zbuluar vlerat e fshehta që mbart fjala në veprën e tij, edhe ne kemi vërejtur se fjala, në poezinë e Kadaresë, nuk është kurrë thjesht njësi leksikore. Ajo bart afërsi natyrore dhe cilësi të dyfishta apo të shumëfishta — të ngjashme me ato që hasim në fizikë, kimi, biologji apo matematikë. Kjo natyrë shumëdimensionale i jep fjalës një tërheqje simbolike, një konotacion magjepsës që zgjon kënaqësi kur kuptohet thellësisht. Tek Kadareja, gjuha nuk është më një mjet i thjeshtë komunikimi — ajo shndërrohet në një forcë të gjallë, reflektuese, që bashkon mendimin me ndjenjën. Në këtë artikull, kemi paraqitur një fjalor të vogël me njëzet fjalë të përzgjedhura, duke nxjerrë në pah rezonancën e tyre simbolike, emocionale dhe konceptuale në universin poetik të Kadaresë.

Lidhja midis Kulturës dhe Natyrës:

Kadareja përshkruan fenomene të natyrës si ylberi apo retë, për t'i dhënë lexuesit një sens universaliteti. Simbolika e këtyre elementeve nënvizon lidhjen mes kulturës dhe natyrës, duke treguar se ato janë pjesë e një universi të pandashëm shpirtëror dhe material. Lejlekët dhe poleni kthehen në metafora për komunikimin midis kulturave dhe historisë universale dhe shpërndarjes së saj në një hapësirë pa kufi.

Karakter i Universal i Gjetjeve:

Këto krijime, me valenca kuptimore që i tejkalojnë kufijtë e një fushe të vetme, tërheqin vëmendjen për lidhjen mes artit, shkencës dhe jetës. Poezia shihet si një instrument i fuqishëm për të ndërtuar urat midis mendimeve dhe për të pasuruar kulturën me një dimension të ri artistik. Muza poetike e poetit shpreh dëshirën për të lidhur kultura e shpërndarë dashurinë, duke lënë pas ëndrra të këqija.

Ky artikull shërben si një përpjekje për të analizuar thellësisht mjetin stilistik dhe nxjerrë në pah imazhet që ato ofrojnë dhe për të zbuluar mënyrën si ato ndikojnë në mendimin dhe interpretimin kulturor, Duke qenë se ai është pjesë e një projekti ndërlëndor, me përfundimin një kabinet të gjuhës shqipe dhe temave letrare, ai ka edhe funksione metodike për një auditor studentor.

Referencat

- [1]. J. J Thomaj, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2008.
- [2]. J. Thomaj, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë 2009 Thomaj, *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, fq. 71.
- [3]. Dhrimo, E. Tupja, Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, botimet EDFA, Tiranë 2007
- [4]. A Podrimja, Parathënie të ^Pika shiu ranë mbi qelq^, fq 2, Tiranë 2003
- [5]. Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, TOENA, 2002
- [6]. N. Kulla, Shqipëria dhe bota në veprën e Kadaresë, Parathënie e albumit, Tiranë 2016, fq.14)
- [7]. N. Kalldrëmxiu, Sh. Rrokaj, Rritja e kompetencës semantike të fëmijët nga mosha 0-12 vjeç, Tiranë 2019
- [8]. N. Kalldrëmxiu, Disa gjedhe fjalëformuese të Kadareja, Studime gjuhësore, 2012, fq.188
- [9]. N. Sotiri, Fjalor i gjuhës së Ismail Kadaresë, Tiranë 2007
- [10]. R. Petro, Çelësi i letërsisë 2, ribotim, 2013, fq. 127
- [11]. Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999
- [12]. Ndhimuan në artikull maturantë të gjimnazëve Babë Dudë Karbunara dhe Ajet Xhindole, si pjesë të projektit kurrikular me të njëjtin titull.